

## **Më 17 korrik Kisha Ortodokse Bullgare nderon Shën Martiren e Madhe Marina**



Në besimet popullore bullgare shenjtorja quhet Marina e Zjarrtë dhe simbolizon zjarrin qiellor. Ajo është mbrojtëse e korrjes, arave dhe mbjelljes. Sipas traditës popullore këtë ditë ndizet zjarr të cilin secili duhet të kërcejë për shëndet.

Ditën e Shën Marinës festën e vet shënon qyteti bregdetar Sozopoll. Shenjtorja konsiderohet mbrojtëse e ujërave dhe e qytetit. Ditë të emrit kanë ata ë mbajnë emra Marin, Marina, Marinella.